



Shpenzimet e komunave për vendime të gjykatave

Municipal Expenses for Court Decisions

(JANAR/JANUARY – GUSHT/AUGUST 2020)

TETOR - OCTOBER 2020

Titulli: Shpenzimet e komunave për vendime të gjykatave (janar -gusht 2020)
Autore: Albana Hasani
Kontriboj: Yllka Buzhala
Viti i botimit: Tetor 2020

Publikuar nga:
Lëvizja FOL
Andrea Gropa nr.35
Prishtina 10000, Republika e Kosovës
info@levizjafol.org
+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Title: Municipal Expenses for Court Decisions
Author: Albana Hasani
Contributor: Yllka Buzhala
Year of publication: October 2020

Published by:
Lëvizja FOL
Str. "Andrea Gropa" no.35
Pristina 10000, Republic of Kosovo
info@levizjafol.org
+386 (0)49 131 542

Copyright ©2020 Lëvizja FOL. All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored in a retrieval system or transmitted in any form or by any means, electronic, mechanical, photocopying, recording or otherwise, without prior permission of the publisher.



Prishtina Office

FOL



Ky botim është realizuar me përkrahjen e platformës “Kosova që duam” dhe i financuar nga Friedrich Ebert Stiftung – zyra në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorëve që janë përgjegjës për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të platformës “Kosova që duam” dhe FES-it.

This publication has been produced with the support of the “Kosovo We Want” platform and funded by Friedrich Ebert Stiftung – office in Pristina. The content of this report reflects the views and opinions of the authors responsible for the factual accuracy of the data presented here. The views and opinions expressed herein do not necessarily represent those of the “Kosovo We Want” platform and of the FES.

Përmbledhja

1.	Përmbledhja Ekzekutive	2
2.	Shpenzimet e Komunave për Vendime të Gjykatave	3
3.	Komuna e Prishtinës	3
4.	Komuna e Mitrovicës së Jugut	4
5.	Komuna e Ferizajt	5
6.	Komuna e Fushë Kosovës	6
7.	Komuna e Skenderajt	7
8.	Komuna e Prizrenit	8
9.	Komuna e Glllogocit	9
10.	Komuna e Gjilanit	10
11.	Komuna e Podujevës	11
12.	Komuna e Malishevës	12
13.	Komuna e Gjakovës	13
14.	Komuna e Kaçanikut	14
15.	Komuna e Pejës	15
16.	Komuna e Klinës	16
17.	Komuna e Zubin Potokut	17
18.	Komuna e Vitisë	18
19.	Komuna e Suharekës	19
20.	Komuna e Deçanit	20
21.	Komuna e Kamenicës	21
22.	Komuna e Lipjanit	22
23.	Komuna e Junikut	23
24.	Komuna e Rahovecit	24
25.	Komuna e Novobërdës	25
26.	Komuna e Obiliqit	26
27.	Komuna e Shtimes	27
28.	Komuna e Vushtrrisë	28
29.	Komuna e Istogut	29
30.	Komuna e Parteshit	30
31.	Komuna e Hanit të Elezit	31
32.	Komuna e Dragashit	32
33.	Komuna e Klllokotit	33
34.	Komuna e Zveçanit	34
35.	Komuna e Graçanicës	35
36.	Përfundim	36
37.	Rekomandimet	37

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Lëvizja FOL, me mbështetjen e Friedrich Ebert Stiftung (FES), ka monitoruar pagesat e ekzekutuara nga Komunitet e Republikës së Kosovës si rezultat i vendimeve të gjykatave. Shpenzimet e larta të komunave si rezultat i detyrimeve që rrjedhin nga këto vendime vazhdojnë të jenë tejet shqetësuese edhe gjatë vitit 2020, përkundër rrethanave të krijuara nga përhapja e pandemisë COVID-19 gjatë kësaj periudhe.

Ky raport përfshinë të dhënat e shpenzimeve për vendimet e gjykatave të të gjitha komunave për periudhën tetë mujore (janar – gusht 2020). Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë bazuar në raportet e dërguara nga Ministria e Pushtetit Lokal (falë bashkëpunimit me zyrtarët e këtij institucioni, e veçanërisht me Sekretaren e Përgjithshme të MPL-së, Rozafa Ukimeraj), në Raportet Financiare të Komunave, të publikuara në ueb - faqet e tyre zyrtare, në të dhënat e publikuara në ueb-faqen e Ministrisë së Financave, si dhe në Ligjin Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Të dhënat përfshijnë kategoritë ekonomike për të cilat ka pasur pagesa gjatë kësaj periudhe: kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe atë të shpenzimeve komunale. Të dhënat e siguruara janë krahasuar me buxhetet fillestare të të gjitha komunave, përkatesisht se sa përqind të buxhetit të komunave për vitin 2020 janë destinuar për pagesat e shpenzimeve për vendime të gjykatave. Gjatë vitit fiskal 2017 të gjitha Komunitet e Republikës së Kosovës kanë paguar shumën prej 9,565,608.55 euro për vendime të gjykatave, ndërkaq komunitet me pagesat më të larta gjatë asaj periudhe ishin: Deçani, Prizreni, Mitrovica e Jugut, Gjakova dhe Ferizaj.

Gjatë vitit 2018 këto pagesa kanë arritur shumën prej 16,425,330.43 euro, respektivisht 71.7% më shumë pagesa se në vitin paraprak. Komunitet me më së shumti pagesa gjatë vitit 2017 ishin: Ferizaj, Kllokoti, Deçani, Mitrovica e Jugut dhe Prizreni. Ndërkaq shpenzimet e larta të këtyre komunave kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2019, ku për vendime të gjykatave janë paguar 15,966.933.45 euro ndërsa Leposaviqi, Ferizaj, Mitrovica e Jugut, Deçani dhe Kllokoti kanë qenë komunitet me më së shumti pagesa për këto vendime, gjatë asaj periudhe.

Ndërkaq gjatë periudhës janar-gusht 2020, Komunitet e

Republikës së Kosovës kanë paguar shumën prej 2,902,259.81 euro për vendime të gjykatave. Kjo ulje e shumëfishtë e shpenzimeve për këto vendime ka ardhur si pasojë e situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë COVID-19 gjatë muajit mars të këtij viti. Gjatë kësaj kohe gjykatat kanë punuar vetëm për raste të natyrës urgjente për katër muaj me radhë (rastet e dhunës në familje, rastet me paraburgim dhe rastet për të mitur), ndërsa nuk kanë punuar me lëndë të natyrës civile. Për shkaqet e lartpërmendura, dhënia e epilogut përfundimtar për këto lëndë ka qenë ini pamundur, duke marrë parasysh faktin se gjatë kësaj periudhe gjykatat kanë punuar vetëm mbi lëndët që kishin prioritet. Megjithatë duke marrë parasysh situatën e krijuar me pandeminë COVID-19, pamundësinë e gjykatave për tu siguruar me këto lëndë për katër muaj me radhë, si dhe periudhën me të shkurtër të monitorimit, shpenzimet e komunave për vendime të gjykatave vazhdojnë të jenë të larta.

Pesë komunitet me më së shumti shpenzime për vendime të gjykatave gjatë periudhës janar-gusht 2020 janë Komuna e Prishtinës, Komuna e Mitrovicës së Jugut, Komuna e Ferizajt, Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Skënderajt. Renditja e komunave në raport është bërë duke filluar prej komunës me më së shumti shpenzime, tek ato më pak. Shpenzimet gjatë kësaj periudhe janë bërë kryesisht për kategorinë mallra dhe shërbime, ku janë paguar 1,985,421.19 euro, ndërsa pjesa tjetër e tyre janë paguar për shpenzime komunale (1,210.6 euro).

Duhet të theksohet se për Komunitet e Mitrovicës së Veriut, Mamushës, Leposaviqit, Shtërpcës dhe Komunitet e Ranillugut, Ministria e Pushtetit Lokal nuk ka pasur të dhëna për shpenzimet e tyre për vendime të gjykatave. Të dhënat për shpenzimet e këtyre komunave për vendimet e gjykatave nuk janë gjetur as në ueb-faqet zyrtare të tyre. Në mungesë të tyre, në këtë raport nuk janë paraqitur të dhënat e shpenzimeve për këto komunitet.

Sa i përket raporteve financiare, disa prej komunave nuk kanë arritur ti publikojnë ato në ueb-faqet e tyre zyrtare, respektivisht kanë dështuar ta informojnë publikun në lidhje me buxhetin e planifikuar të komunës për vitin përkatës, si dhe për shpenzimet financiare të komunës, duke përfshirë edhe shpenzimet si rezultat i vendimeve të gjykatave. Përveç kësaj, duhet të theksohet se raportet financiare të publikuara prej disa komunave kanë qenë vështirë të kuptueshme dhe kjo për shkak të mos standardizimit të formave elektronike të raporteve financiare.

1. Për më tepër shih: Pagesat e Vendimeve Gjyqësore nga Komunitet (vitet 2017, 2018, 2019), mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, Lëvizja FOL, Prishtinë, korrik 2020.

2. Të dhëna të siguruara përmes përgjigjes në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal, të pranuar me 7 gusht 2020.

SHPENZIMET E KOMUNAVE PËR VENDIME TË GJYKATAVE

KOMUNA E PRISHTINËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Prishtinës ka shpenzuar shumën prej 1,038,182.43 euro për vendime të gjykatave. Me këtë shumë kjo komunë renditet si komuna me më së shumti shpenzime për vendime të gjykatave gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 91,579,504.00 euro në total, këto shpenzime zënë 1.13 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Ndërkaq shuma prej 1,038,182.43 euro është ekzekutuar për 81 lëndë në të cilat kjo komunë ka qenë e përfshirë si palë.

Raportet financiare të Komunës së Prishtinës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës

për qasje në dokumente zyrtare drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Duhet të theksohet se ueb-faqja zyrtare e Komunës së Prishtinës gjatë kësaj periudhe ka arritur të menaxhohet mjaft mirë, duke i paraqitur të dhënat e nevojshme, raportet financiare dhe shpenzimet komunale për periudhat përkatëse.

Duhet theksuar se kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 1,599,389.42 euro, të cilat ishin bërë për tri kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje e ndjeshme shpenzimeve gjatë periudhës janar – gusht 2020 ka ardhur si pasojë e rrethanave të krijuara nga përhapja e pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar vetëm për raste të natyrës urgjente dhe jo me kapacitet të plotë.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	1,599,389.42 €	1,038,182.43 €
Buxheti fillestar:	87,733,820.00 €	91,579,504.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1,82 %	1.13 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	317 lëndë	81 lëndë

Figura 1. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Prishtinës.

KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka shpenzuar shumën prej 242,932.60 euro për vendime të gjykatave. Kjo është komuna e dytë me më së shumti shpenzime për vendime të gjykatave gjatë kësaj periudhe. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 22,115,361.00 euro në total, këto shpenzime zënë 1.09 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 242,932.60 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 80.

Raportet financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar

përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Duhet të theksohet se ueb-faqja zyrtare e Komunës së Mitrovicës së Jugut nuk ka qenë mjaftueshëm informuese për të dhënat mbi shpenzimet e komunave dhe raportet financiare.

Kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 1,476,047.81 euro, të cilat ishin bërë vetëm për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë kësaj periudhe ka ardhur për shkak se gjykatat kanë punuar me kapacitet të zvogëluar dhe vetëm për rastet urgjente, si masë e nevojshme në luftën kundër përhapjes së pandemisë COVID-19

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	1,476,047.81 €	242,932.60 €
Buxheti fillestar:	19,803,020.00 €	22,115,361.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	7.45 %	1.09 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	175 lëndë	80 lëndë

Figura 2. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Mitrovicës së Jugut.

KOMUNA E FERIZAJT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Ferizajt ka shpenzuar shumën prej 230,139.74 euro për vendime të gjykatave, duke u renditur e treta me radhë sa i përket këtyre shpenzimeve. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 33,463,633.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.68 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 230,139.74 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 97.

Raportet financiare të Komunës së Ferizajt për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës

për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Duhet të theksohet se ueb-faqja zyrtare e Komunës së Ferizajt ka arritur të menaxhohet në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe dhe ka qenë mirë e pajisur me raporte financiare vjetore dhe të dhëna të tjera për shpenzimet komunale.

Kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 4,562,588.71 euro, të cilat ishin bërë për katër kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale, shërbime komunale dhe subvencione dhe transfere. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë periudhës janar-gusht 2020 ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID 19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	4,562,588.71 €	230,139.74 €
Buxheti fillestar:	36,976,910.00 €	33,463,633.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	12.34 %	0.68 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	391 lëndë	97 lëndë

Figura 3. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Ferizajt.

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Fushë Kosovës ka shpenzuar shumën prej 206,803.64 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 12,608,367.00 euro në total, këto shpenzime zënë 1,64 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 206,803.64 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 21.

Raportet financiare për vitin 2020 të kësaj komune janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Fushë Kosovës ka

qenë e pajisur mjaftueshëm me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Fushë Kosovës është ndër komunat e pakta, që përkundër situatës së krijuar me pandeminë COVID-19, gjatë periudhës janar-gusht 2020 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime sesa gjatë vitit 2019. Gjatë vitit 2019 Komuna e Fushë Kosovës për vendime të gjykatave kishte shpenzuar shumën prej 91,555.28 €. Këto shpenzime ishin bërë për tri kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	91,555.28 €	206,803.64 €
Buxheti fillestar:	13,623,600.00 €	12,608,367.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	0.67 %	1.64 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	81 lëndë	21 lëndë

Figura 4. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Fushë Kosovës.

KOMUNA E SKENDERAJT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Skenderajt ka shpenzuar shumën prej 204,717.75 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 14,950,500.00 euro në total, këto shpenzime zënë 1.36% të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 204,717.75 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 31.

Raportet financiare të Komunës së Skenderajt për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Gjithashtu, ueb-faqja e Komunës së

Skenderajt ka qenë e pajisur mjaftueshëm me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Skenderajt gjatë vitit 2019 ka pasur më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 228,033.43 €. Këto shpenzime ishin bërë për tri kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale dhe shërbime komunale. Ulja e ndjeshme e këtyre shpenzimeve gjatë kësaj periudhe ka ardhur si rrjedhojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, ku gjykatat për katër muaj kanë punuar vetëm për raste urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	228,033.43 €	204,717.75 €
Buxheti fillestar:	13,406,280.00 €	14,950,500.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1.70%	1.36%
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	102 lëndë	31 lëndë

Figura 5. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Skenderajt.

KOMUNA E PRIZRENIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Prizrenit ka shpenzuar shumën prej 185,108.42 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 50,901,460.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.36 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 185,108.42 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 166.

Raportet financiare të Komunës së Prizrenit për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Prizrenit ka arritur të

menaxhohet tejte mirë gjatë kësaj periudhe të monitorimit, duke përbajtur të dhënat e nevojshme për shpenzimet e komunave dhe për raportet financiare.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 662,271.28 euro, të cilat ishin bërë vetëm për një kategori buxhetore: mallra dhe shërbime. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti, sikur tek komunat tjera, ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID -19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	662,271.28 €	185,108.42 €
Buxheti fillestar:	47,594,260.00 €	50,901,460.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1.39 %	0.36 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	242 lëndë	166 lëndë

Figura 6. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Prizrenit.

KOMUNA E GLOGOCIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Glogocit ka shpenzuar shumën prej 95,291.67 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestarë të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 16,490,343.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0,58 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 95,291.67 € për këtë tetë mujorë ka qenë 19 lëndë.

Raportet financiare për vitin 2020 të kësaj komune janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Gjithashtu edhe ueb-faqja e Komunës së

Skenderajt ka qenë e pajisur mjaftueshëm me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Përndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 604,455.14 euro, të cilat ishin bërë për katër kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve, sikurse tek komunat tjera, ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	604,455.14 €	95,291.67 €
Buxheti fillestar:	15,171,600.00 €	16,490,343.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	3.98%	0.58 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	141 lëndë	19 lëndë

Figura 7. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Glogocit.

KOMUNA E GJILANIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Gjilanit ka shpenzuar shumën prej 85.206.82 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 27,509,087.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.30 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 85.206.82 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 22.

Raportet financiare të Komunës së Gjilanit për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Gjithashtu edhe ueb-faqja e Komunës së

Gjilanit ka qenë mjaftueshëm e pajisur me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Përndryshe, edhe kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 589,760.47 euro, të cilat ishin bërë vetëm për një kategori buxhetore: mallra dhe shërbime. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	589,760.47 €	85.206.82 €
Buxheti fillestar:	25,544,790.00 €	27,509,087.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	13.21 %	0.30 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	142 lëndë	22 lëndë

Figura 8. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Gjilanit.

KOMUNA E PODUJEVËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Podujevës ka shpenzuar shumën prej 73,942.95 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 24,086,270.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.31 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 73,942.95 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 42.

Raportet financiare për vitin 2020 të kësaj komune janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Podujevës ka arritur

të menaxhohet tejet mirë gjatë kësaj periudhe të monitorimit, duke përbajtur të dhënat e nevojshme për shpenzimet e komunave dhe për raportet financiare.

Komuna e Podujevës gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 206,954.03 euro, të cilat ishin bërë për katër kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID 19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	206,954.03 €	73,942.95 €
Buxheti fillestar:	25,544,790.00 €	24,086,270.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	13.21 %	0.31 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	142 lëndë	42 lëndë

Figura 9. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Podujevës.

KOMUNA E MALISHEVËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Malishevës ka shpenzuar shumën prej 73,370.11 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 15,583,802.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.24 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 73,370.11 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 16.

Raportet financiare të Komunës së Malishevës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Gjithashtu edhe ueb- faqja e Komunës së

Malishevës ka qenë mjaftueshëm e pajisur me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Malishevës gjatë vitit 2019 ka pasur më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 399,060.44 €, të cilat ishin bërë vetëm për tri kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID 19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	399,060.44 €	73,370.11 €
Buxheti fillestar:	14,392,380.00 €	15,583,802.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	2.77 %	0.24 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	89 lëndë	16 lëndë.

Figura 10. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Malishevës.

KOMUNA E GJAKOVËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Gjakovës ka shpenzuar shumën prej 64,405.53 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 27,252,717.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.24 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime.. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 64,405.53 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 16.

Raportet financiare të Komunës së Gjakovës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Gjakovës ka arritur të

menaxhohet tejte mirë gjatë kësaj periudhe të monitorimit, duke përbajtur të dhënat e nevojshme për shpenzimet e komunave dhe për raportet financiare.

Si shumica e komunave, edhe Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 845,545.71 euro, të cilat ishin bërë vetëm për tri kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente .

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	845,545.71 €	64,405.53 €
Buxheti fillestar:	24,785,170.00 €	27,252,717.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	3.41%	0.24 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	233 lëndë	16 lëndë.

Figura 11. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Gjakovës.

KOMUNA E KAÇANIKUT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Kaçanikut ka shpenzuar shumën prej 61,100.62 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 9,000,530.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.67% të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime (61,100.62 euro) dhe shërbime komunale (405.1 euro). Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 61,100.62 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 37.

Raportet financiare të Komunës së Kaçanikut për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së

Pushtetit Lokal. Edhe ueb-faqja e Komunës së Malishevës ka qenë mjaftueshëm e pajisur me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime të gjykatave, respektivisht 358,850.57 euro, të cilat ishin bërë vetëm për tri kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	358,850.57 €	61,100.62 €
Buxheti fillestar:	8,667,339.00 €	9,000,530.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	4.14 €	0.67%
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	90 lëndë	37 lëndë.

Figura 12. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Kaçanikut.

KOMUNA E PEJËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Pejës ka shpenzuar shumën prej 58,200.83 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 28,545,321.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.20 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 58,200.83 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 15.

Raportet financiare të Komunës së Pejës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Duhet të theksohet se ueb-faqja zyrtare e

Komunës së Pejës ka pasur mungesë të të dhënave për shpenzime komunale dhe të raporteve financiare gjatë kësaj periudhe të monitorimit.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 853,810.90 euro, të cilat ishin bërë vetëm për tri kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, shërbime komunale dhe investime kapitale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	853,810.90 €	58,200.83 €
Buxheti fillestar:	26,598,410.00 €	28,545,321.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	3.21 %	0.20 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	37 lëndë.	15 lëndë.

Figura 13. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Pejës.

KOMUNA E KLINËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Klinës ka shpenzuar shumën prej 52,238.51 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 11,054,140.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.47% të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 52,238.51 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 47.

Raportet financiare të Komunës së Klinës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Duhet të theksohet se ueb-faqja zyrtare e

Komunës së Klinës ka pasur mungesë të të dhënave dhe raporteve financiare.

Kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 104,067.70 euro, të cilat ishin bërë vetëm për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	104,067.70 €	52,238.51€
Buxheti fillestar:	10,138,950.00 €	11,054,140.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1.03 %	0.47%
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	153 lëndë.	47 lëndë.

Figura 14. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Klinës.

KOMUNA E ZUBIN POTOKUT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Zubin Potokut ka shpenzuar shumën prej 45,656.92 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 19,939,966.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.20 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 45,656.92 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 11.

Raportet financiare të Komunës së Zubin Potokut për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Zubin Potokut ka

dështuar të menaxhohet në mënyrën e duhur, duke pasur mungesë të të dhënave themelore për informimin e publikut.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 50,239.10 euro, të cilat ishin bërë vetëm për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë kësaj periudhe ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	50,239.10 €	45,656.92 €
Buxheti fillestar:	2,569.792.00 €	19,939,966.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1.93 %	0.20 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	11 lëndë	11 lëndë.

Figura 15. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Zubin Potokut.

KOMUNA E VITISË

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Vitisë ka shpenzuar shumën prej 39,542.16 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 12,305,490.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.32 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 39,542.16 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 16.

Raportet financiare të Komunës së Vitisë për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb- faqja e Komunës së Vitisë ka qenë

mjaftueshëm e pajisur me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 155,430.09 euro, të cilat ishin bërë për katër kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale, shërbime komunale dhe subvencione dhe transfere. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	39,542.16 €	39,542.16 €
Buxheti fillestar:	12,305,490.00 €	12,305,490.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1.36 %	0.32 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	74 lëndë	16 lëndë.

Figura 16. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Vitisë.

KOMUNA E SUHAREKËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Suharekës ka shpenzuar shumën prej 35,748.77 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 14,735,820.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.24 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 35,748.77 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 16.

Raportet financiare të Komunës së Suharekës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Suharekës ka qenë

mjaftueshëm e pajisur me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 186,490.14 euro, të cilat ishin bërë vetëm për tri kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	186,490.14 €	35,748.77 €
Buxheti fillestar:	16,260,040.00 €	14,735,820.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1,15 %	0.24 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	103 lëndë.	16 lëndë.

Figura 17. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Suharekës.

KOMUNA E DEÇANIT

Gjatë periudhës janar-gusht 2020, Komuna e Deçanit si rezultat i pagesave për vendimet e gjykatave ka shpenzuar shumën prej 34,694.66 euro nga totali prej 9,731,595.00 euro të buxhetit fillestar, apo 0,36% të shumës së këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 34,694.66 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 8 lëndë.

Raportet financiare të Komunës së Deçanit për vitin 2020 janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave. Ndërkaq të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb- faqja e Komunës së Deçanit ka qenë

mjaftueshëm e pajisur me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Edhe Komuna e Deçanit hynë në mesin e komunave që gjatë vitit 2019 kanë pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore. Kjo komunë gjatë vitit paraprak ka shpenzuar shumën prej 569,992.56 euro, të cilat ishin bërë për tri kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	569,992.56 €	34,694.66 €
Buxheti fillestar:	8,951,356.00 €	9,731,595.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	6.37 %	0.36 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	78 lëndë	8 lëndë

Figura 18. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Deçanit.

KOMUNA E KAMENICËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Kamenicës ka shpenzuar shumën prej 29,638.08 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 9,401,944.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.31% të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 29,638.08 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 13.

Raportet financiare të Komunës së Kamenicës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Kamenicës nuk ka

arritur të menaxhohet si duhet nga zyrtarët e saj, duke pasur mungesë të të dhënave për shpenzime komunale dhe raporte financiare.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 166,282.23 euro, të cilat ishin bërë vetëm për katër kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale, shërbime komunale dhe subvencione dhe transfere. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	166,292.23 €	29,638.08 €
Buxheti fillestar:	9,059,709.00 €	9,401,944.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1,78 %	0.31 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	70 lëndë.	13 lëndë.

Figura 19. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Kamenicës.

KOMUNA E LIPJANIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Lipjanit ka shpenzuar shumën prej 27,461.52 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 18,005,722.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.15 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 27,461.52 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 19.

Raportet financiare për vitin 2020 të kësaj komune janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb- faja e Komunës së Lipjanit ka qenë

mjaftueshëm e pajisur me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Edhe kjo Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 184,733.44 euro, të cilat ishin bërë për katër kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	184,733.44 €	27,461.52 €
Buxheti fillestar:	16,884,640.00 €	18,005,722.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1.09 €	0.15 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	100 lëndë.	19 lëndë.

Figura 20. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Lipjanit.

KOMUNA E JUNIKUT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Junikut ka shpenzuar shumën prej 18,700.65 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 1,627,946.00 euro në total, këto shpenzime zënë 1.14% të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 18,700.65 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 15.

Raportet financiare të Komunës së Junikut për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal Ueb- faqja e Komunës së Junikut ka qenë

mjaftueshëm e pajisur me të dhëna dhe raporte financiare gjatë kësaj periudhe.

Ndërkaq gjatë vitit 2019 Komuna e Junikut ka shpenzuar shumën prej 1,175.25 euro për vendime të gjykatave. Kjo nënkupton që, përkundër situatës së krijuar me pandeminë COVID-19 dhe pamundësisë së gjykatave për tu siguruar me këto lëndë për katër muaj me radhë gjatë këtij tetë mujori, gjatë vitit 2019 kjo komunë ka pasur shumë më pak shpenzime për vendime të gjykatave. Këto shpenzime ishin bërë vetëm për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	1,175.25 €	18,700.65 €
Buxheti fillestar:	1,784,765.00 €	1,627,946.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	0.07 %	1.14 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	3 lëndë	15 lëndë.

Figura 21. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Junikut.

KOMUNA E RAHOVECIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Rahovecit ka shpenzuar shumën prej 16,898.18 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 14,735,820.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.11 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 16,898.18 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 16.

Raportet financiare të Komunës së Rahovecit për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Rahovecit ka arritur të

mirëmbahet mjaft mirë nga zyrtarët e kësaj komune, duke përmbytur raportet financiare, si dhe të dhëna për shpenzimet e komunës.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 187,443.95 euro, të cilat ishin bërë vetëm për tri kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë kësaj periudhe ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	187,443.95 €	16,898.18 €
Buxheti fillestar:	13,760,230.00 €	14,735,820.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1.36 %	0.11 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	63 lëndë.	16 lëndë.

Figura 22. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Rahovecit.

KOMUNA E NOVOBËRDËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Novobërdës ka shpenzuar shumën prej 15,690.08 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 3,075,633.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.51% të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 15,690.08 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 16.

Raportet financiare të Komunës së Novobërdës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Duhet të theksohet se ueb-faqja zyrtare e

Komunës së Novobërdës gjatë kësaj periudhe ka pasur mungesë të të dhënave dhe raporteve financiare.

Kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 48,576.26 euro, të cilat ishin bërë vetëm për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, investime kapitale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	48,576.26 €	15,690.08 €
Buxheti fillestar:	2,781,639.00 €	3,075,633.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1,75 %	0.51 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	32 lëndë.	16 lëndë

Figura 23. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Novobërdës.

KOMUNA E OBILIQIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Obiliqit ka shpenzuar shumën prej 11,565.23 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 11,437,447.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.10 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 11,565.23 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 11.

Raportet financiare për vitin 2020 të kësaj komune janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Obiliqit gjatë

kësaj periudhe ka qenë e pajisur mjaftueshëm me të dhëna dhe raporte financiare.

Edhe Komuna e Obiliqit gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime të gjykatave, respektivisht 24,188,80 euro, të cilat ishin bërë për katër kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	24,188,80 €	11,565.23 €
Buxheti fillestar:	12,875,470.00 €	11,437,447.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	0.19 %	0.10 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	37 lëndë	11 lëndë

Figura 24. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Obiliqit.

KOMUNA E SHTIMES

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Shtimes ka shpenzuar shumën prej 10,633.72 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 7,937,712.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.13% të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 10,633.72 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 6.

Raportet financiare të Komunës së Shtimes për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Shtimes gjatë

kësaj periudhe ka qenë e pajisur mjaftueshëm me të dhëna dhe raporte financiare.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 121,362.03 euro, të cilat ishin bërë për tri kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	121,362.03 €	10,633.72 €
Buxheti fillestar:	9,642,985.00 €	7,937,712.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1,26 %	0.13%
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	46 lëndë.	6 lëndë.

Figura 25. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Shtimes.

KOMUNA E VUSHTRRIË

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar shumën prej 6,467.81 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 19,939,966.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.30 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 6,467.81 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 21.

Raportet financiare të Komunës së Vushtrrisë për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Vushtrrisë

gjatë kësaj periudhe ka qenë e pajisur mjaftueshëm me të dhëna dhe raporte financiare.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 112,267.49 euro, të cilat ishin bërë vetëm për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime, shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	112,267.49 €	6,467.81 €
Buxheti fillestar:	2,546,784.00 €	19,939,966.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	4.41 %	0.30 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	63 lëndë	21 lëndë

Figura 26. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Vushtrrisë.

KOMUNA E ISTOGUT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Istogut ka shpenzuar shumën prej 6,128.03 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 11,461,426.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.05% të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 6,128.03 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 4.

Raportet financiare të Komunës së Istogut për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Duhet të theksohet se ueb-faqja zyrtare e

Komunës së Istogut gjatë kësaj periudhe ka qenë e pajisur mirë me të dhëna dhe raporte financiare.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 70,916.28 euro, të cilat ishin bërë vetëm për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	70,916.28 €	6,128.03 €
Buxheti fillestar:	15,722,360.00 €	11,461,426.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	0.45 %	0.05 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	43 lëndë	4 lëndë

Figura 27. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Istogut.

KOMUNA E PARTESHIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Parteshit ka shpenzuar shumën prej 6,078.31 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 1,214,028.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.50 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 6,078.31 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 16.

Raportet financiare të Komunës së Parteshit për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së

Pushtetit Lokal. Komuna e Parteshit nuk ka arritur ta mirëmbajë si duhet ueb-faqen e saj. Gjatë kësaj periudhe në ueb faqen e kësaj komune nuk është publikuar asnjë raport financiar apo të dhëna të tjera të nevojshme për informimin e publikut.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 10,022.72 euro, të cilat ishin bërë për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID 19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	10,022.72 €	6,078.31 €
Buxheti fillestar:	1,243,873.00 €	1,214,028.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	0.81 %	0.50 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	8 lëndë	16 lëndë.

Figura 28. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Parteshit.

KOMUNA E HANIT TË ELEZIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Hanit të Elezit ka shpenzuar shumën prej 4,124.30 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 2,742,095.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.15 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë për një kategori buxhetore: mallra. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 4,124.30 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 2. Raportet financiare të Komunës së Hanit të Elezit për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Hanit të Elezit ka qenë mjaftueshëm e pajisur me të dhëna për shpenzimet e

komunës, si dhe raporte financiare. Përndryshe edhe kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 7,578.47 euro, të cilat ishin bërë për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Kjo ulje e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	7,578.47 €	4,124.30 €
Buxheti fillestar:	3,109,110.00 €	2,742,095.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	0.24 %	0.15 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	15 lëndë	2 lëndë.

Figura 29. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Hanit të Elezit.

KOMUNA E DRAGASHIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Dragashit ka shpenzuar shumën prej 3,575.55 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 9,045,190.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.03 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 3,575.55 euro për këtë tetë mujorë ka qenë 6.

Raportet financiare të Komunës së Dragashit për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Dragashit ka

qenë mjaftueshëm e pajisur me të dhëna për shpenzimet e komunës, si dhe raporte financiare.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 11,374.60 euro, të cilat ishin bërë për tri kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	11,374.60 €	3,575.55 €
Buxheti fillestar:	8,404,652.00 €	9,045,190.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	2.27 %	0.03 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	30 lëndë.	6 lëndë.

Figura 30. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Dragashit.

KOMUNA E KLLOKOTIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Klllokotit ka shpenzuar shumën 791.74 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 1,137,495.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.06 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 791.74 euro për këtë tetë mujorë ka qenë vetëm 1.

Raportet financiare të Komunës së Klllokotit për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ueb-faqja e Komunës së Klllokotit ka dështuar

të menaxhohet në mënyrën e duhur, duke pasur mungesë të raporteve financiare, e madje edhe të dhënave themelore për informimin e publikut.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 62,260.30 euro, të cilat ishin bërë për dy kategori buxhetore: mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	62,260.30 €	791.74 €
Buxheti fillestar:	1,241,812.00 €	1,137,495.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	5.01%	0.06 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	15 lëndë.	1 lëndë.

Figura 31. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Klllokotit.

KOMUNA E ZVEÇANIT

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Zveçanit ka shpenzuar shumën prej 629.9 euro për vendime të gjykatave. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 2,435,329.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.02% të këtij buxheti. Me këtë shumë, kjo komunë renditet e parafundit sa i përket shpenzimeve për vendime të gjykatave. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 629.9 euro për këtë tetë mujorë ka qenë vetëm 1.

Raportet financiare të Komunës së Zveçanit për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës

për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Edhe Komuna e Zveçanit ka dështuar të menaxhohet në mënyrën e duhur, duke pasur mungesë të raporteve financiare, e madje edhe të dhënave themelore për informimin e publikut.

Komuna e Zveçanit gjatë vitit 2019 ka pasur shumëfish më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 27,758.65 euro, të cilat ishin bërë vetëm për një kategori buxhetore: mallra dhe shërbime. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë këtij viti ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	27,758.65 €	629.9 €
Buxheti fillestar:	2,501,643.00 €	2,435,329.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	1.11 %	0.02 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	1 lëndë.	1 lëndë

Figura 32. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Zveçanit.

KOMUNA E GRAÇANICËS

Gjatë periudhës janar – gusht 2020, Komuna e Graçanicës ka shpenzuar shumën prej 588.8 euro për vendime të gjykatave. Me këtë shumë, Komuna e Graçanicës renditet si komuna me më së paku shpenzime për vendime të gjykatave gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Ndërkaq në raport me buxhetin fillestar të kësaj komune, i cili për vitin 2020 ishte vlerësuar 8,101,328.00 euro në total, këto shpenzime zënë 0.007 % të këtij buxheti. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pagesat nga kjo komunë janë bërë vetëm për kategorinë mallra dhe shërbime. Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë pjesë dhe është detyruar të paguaj shumën prej 588.8 euro për këtë tetë mujorë ka qenë vetëm 6.

Raportet financiare të Komunës së Graçanicës për këtë vit janë siguruar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, ndërsa të dhënat e detajuara të shpenzimeve gjyqësore për

periudhën janar – gusht 2020 janë siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare të drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal. Edhe ueb-faqja e Komunës së Graçanicës gjatë kësaj periudhe ka pasur mungesë të raporteve financiare të publikuara dhe të dhëna të tjera për shpenzimet komunale.

Ndryshe, kjo komunë gjatë vitit 2019 ka pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime gjyqësore, respektivisht 31,298.86 euro, të cilat ishin bërë për tri kategori buxhetore: investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale. Kjo ulje drastike e shpenzimeve gjatë kësaj periudhe ka ardhur si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19, për shkak të së cilës gjykatat kanë punuar me staf të reduktuar, vetëm për rastet urgjente.

	2019	janar - gusht 2020
Shumat e pagesave për vendimet e gjykatave:	31,298.86 €	588.8 €
Buxheti fillestar:	13,184,950.00 €	8,101,328.00 €
Krahasimi në përqindje ndërmjet pagesave për vendime të gjykatave dhe buxhetit fillestar:	0.24 %	0.007 %
Numri i lëndëve në të cilat komuna ka qenë palë:	14 lëndë.	6 lëndë.

Figura 33. Të dhënat e pagesave për vendime të gjykatave për Komunën e Graçanicës

PËRFUNDIM

Komunat e Republikës së Kosovës kanë vazhduar të ekzekutojnë pagesa të larta për vendime të gjykatave edhe gjatë periudhës janar-gusht 2020, përkundër faktit se gjatë kësaj periudhe gjykatat u obliguan të punojnë vetëm për raste të natyrës urgjente, në rrethin e të cilave këto lëndë nuk ishin të përfshira.

Gjatë periudhës janar–gusht 2020, Komunat e Republikës së Kosovës për vendime të gjykatave kanë shpenzuar shumën 2,902,259.81 euro, apo 8,47 % të buxhetit fillestar të paraparë për të gjitha Komunat e Kosovës, që për vitin 2020 ishte vlerësuar 34,246,769.00 euro. Në këtë shumë përfshihen edhe shpenzimet e bëra nga të hyrat vetanake.

Pra gjatë kësaj periudhe vërehet ulje e theksuar shpenzimeve për vendime të gjykatave në krahasim me vitet paraprake. Kjo ulje e shpenzimeve ka ardhur si rrjedhojë e situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë COVID-19 gjatë muajit mars të këtij viti, ku gjykatat kanë punuar vetëm për raste të natyrës urgjente për katër muaj me radhë (rastet e dhunës në familje, rastet me paraburgim dhe rastet për të mitur etj.). Rrjedhimisht, procedimi me lëndë të tilla ka qenë i pamundur gjatë kësaj periudhe. Megjithatë duke i marrë parasysh këto shkaqe dhe kohën e shkurtër të ekzekutimit të këtyre pagesave, pagesat e komunave për këto vendime vazhdojnë të jenë të larta dhe rënduese për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Komunat të cilat kanë shpenzuar më së shumti për vendime të gjykatave gjatë kësaj periudhe janë: Komuna e Prishtinës (1,038,182.43 euro), Komuna e Mitrovicës së Jugut (242,932.60 euro), Komuna e Ferizajt (230,139.74 euro), Komuna e Fushë Kosovës (206,803.64 euro) dhe Komuna e Skenderajt (204,717.75 euro).

Ndërkaq komunat me më së paku shpenzime për vendime të gjykatave gjatë kësaj periudhe janë: Komuna e Graçanicës (588.8 euro), Komuna e Zveçanit (629.9 euro), Komuna e Kllokotit (791.74 euro), Komuna e Dragashit (3,575.55 euro), si dhe Komuna e Hanit të Elezit (4,124.30 euro).

Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Junikut janë komunat e vetme të cilat, përkundër situatës së krijuar me pandeminë, gjatë kësaj periudhe tetë mujore kanë pasur dukshëm më shumë shpenzime për vendime të gjykatave, sesa gjatë tërë vitit 2019. Komuna e Fushë Kosovës gjatë vitit

2019 kishte shpenzuar shumën prej 91,555.28 euro për vendime të gjykatave, ndërsa gjatë periudhës janar-gusht 2020 këto shpenzime kanë arritur shumën prej 206,803.64 euro, apo 126 % më shumë se në vitin paraprak. Ndërsa Komuna e Junikut, e cila në vitin 2019 kishte shpenzuar 1,175.25 euro për vendime të gjykatave, gjatë periudhës janar-gusht 2020 këto shpenzime kishin arritur në 18,700.65 euro, apo 1491.21% më shumë se në vitin paraprak.

Ndërkaq numri i përgjithshëm i lëndëve në të cilat komunat kanë qenë palë gjatë periudhës janar-gusht 2020 ka qenë 887 lëndë.

Pagesat e larta të komunave për vendimet e gjykatave vazhdojnë të jenë barrë e rëndë për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Duke vazhduar me këtë mënyrë veprimi, duke mos respektuar dispozitat ligjore, aktet tjera nënligjore dhe detyrimet kontraktuale të komunës, përveç që si pasojë ka rëndimin e Buxhetit të Komunës, kjo instalon një kulturë institucionale e cila do të ketë efekte negative financiare afatgjate dhe si pasojë do të vihet në pikëpyetje funksionimi i rregullt dhe efikas i njësive të vetëqeverisjes lokale. Prandaj ndërmarrja e masave në këtë drejtim, jo vetëm që është e nevojshme për ruajtjen e buxhetit të shtetit, por është edhe e domosdoshme për rritjen e efikasitetit të institucioneve komunale.

Të dhëna të siguruara në ueb-faqen e Ministrisë së Financave dhe në Ligjin Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMET

- Gjatë projektimit të buxhetit vjetor të komunave, të vlerësohet alokimi i mjeteve buxhetore për pagesat e obligimeve të komunës në kuadër të kompensimit të pagave jubilarë, nëse një gjë e tillë parashihet me dispozita ligjore;
- Ngritja e kapaciteteve të zyrave ligjore komunale, duke e rritur stafin dhe duke organizuar trajnime në përditësimin e informatave mbi zbatimin e dispozitave ligjore;
- Organizimi i trajnimeve për zyrtarët dhe përfaqësuesit ligjorë të komunave, me qëllim të avancimit dhe kuptimit të obligimeve ligjore që dalin nga Ligji i Punës dhe çështjeve nga procedura përmbartimore;
- Mbajtja e takimeve të përfaqësuesve të komunave me Avokaturën Shtetërore, që do të shërbente në shkëmbimin e përvojave dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të publikohen në ueb-faqet e komunave raportet financiare në lidhje me shpenzimet komunale dhe të dhënat tjera të nevojshme për informimin e publikut, si dhe të standardizohet forma e këtyre raporteve.

REFERENCAT :

- Pagesat e Vendimeve Gjyqësore nga Komunitat (vitet 2017, 2018, 2019), mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, Lëvizja FOL, Prishtinë, korrik 2020.
- Përgjigjja në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal, të pranuar me 7 gusht 2020
- LIGJI NR. 07/L-001 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2020, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 1 / 19 MARS 2020, PRISHTINË.
<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf?fbclid=IwAR27gUdiwFwUN6J6Zry8tpPyKNKw2UzhD5BX4ufy-qEhxGHTGVbSoe5mPAY>.



Municipal Expenses for Court Decisions

(JANUARY - AUGUST 2020)

OCTOBER 2020

Content:

1.	EXECUTIVE SUMMARY	2
2.	MUNICIPAL EXPENSES FOR COURT DECISIONS	3
3.	MUNICIPALITY OF PRISHTINA	3
4.	MUNICIPALITY OF SOUTH MITROVICA	4
5.	MUNICIPALITY OF FERIZAJ	5
6.	MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVA	6
7.	MUNICIPALITY OF SKENDERAJ	7
8.	MUNICIPALITY OF PRIZREN	8
9.	MUNICIPALITY OF GLLOGOC	9
10.	MUNICIPALITY OF GJILAN	10
11.	MUNICIPALITY OF PODUJEVA	11
12.	MUNICIPALITY OF MALISHEVA	12
13.	MUNICIPALITY OF GJAKOVA	13
14.	MUNICIPALITY OF KAÇANIK	14
15.	MUNICIPALITY OF PEJA	15
16.	MUNICIPALITY OF KLINA	16
17.	MUNICIPALITY OF ZUBIN POTOK	17
18.	MUNICIPALITY OF VITIA	18
19.	MUNICIPALITY OF SUHAREKA	19
20.	MUNICIPALITY OF DEÇAN	20
21.	MUNICIPALITY OF KAMENICA	21
22.	MUNICIPALITY OF LIPJAN	22
23.	MUNICIPALITY OF JUNIK	23
24.	MUNICIPALITY OF RAHOVEC	24
25.	MUNICIPALITY OF NOVOBËRDA/ Novo Brdo	25
26.	MUNICIPALITY OF OBILIQ	26
27.	MUNICIPALITY OF SHTIME	27
28.	MUNICIPALITY OF VUSHTRRIA	28
29.	MUNICIPALITY OF ISTOG	29
30.	MUNICIPALITY OF PARTESH	30
31.	MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT	31
32.	MUNICIPALITY OF DRAGASH	32
33.	MUNICIPALITY OF KLOKOT	33
34.	MUNICIPALITY OF ZVEÇAN	34
35.	MUNICIPALITY OF GRACANICA	35
36.	CONCLUSION	36
37.	RECOMMENDATIONS	37

EXECUTIVE SUMMARY

FOL Movement, with the support of the Friedrich Ebert Stiftung (FES), has monitored the payments executed by the Municipalities of the Republic of Kosovo as a result of court decisions. The high expenditures of municipalities as a result of the obligations arising from these decisions continue to be extremely worrying during 2020, despite the circumstances created by the spread of the COVID-19 pandemic during this period.

